

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Rikonstrukcion i kopshtit Bep Tusha

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7 - Punë ndërtimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 46,596,867 (Katërdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 dhe 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 *“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”*, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht:

Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar, nën 29 i tij i cili përcakton *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr. 5 datë 30.01.2006 *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, i ndryshuar pika 3.12 e tij, dhe kërkesave të **Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018** *“Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* nën 9 i tij ku parashikohet: *“Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”*.

Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 *“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”* (i ndryshuar) nën 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 *“Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”* gjykojmë që të kërkojmë xhiron vjetore dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2022, 2023, 2024) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2024** dhe kestet e maturuara për vitin **2025**, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar), lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi: Njësia e prokurimit kërkoi edhe pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (të ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se dyfishi** i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

a) Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- a. Kontratën e Sipërmarrjes,
- b. Situacionin përfundimtar të objektit
- c. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d. Aktin e Kolaudimit të objektit
- e. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
- f. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtme:

- a. Kontratën e Sipërmarrjes,
- b. Situacionin përfundimtar të objektit
- c. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore
- d. Aktin e Kolaudimit të objektit
- e. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9

Shenim: Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale**. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi

për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturs dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*” të ndryshuar, e cila përfshin kategorite e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- NP-1 A “Punime gjurmimi në tokë”;
- NP-2 A “Ndërtime civile dhe industriale”;
- NP-3 A “Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada”;
- NP-12 A “Punime të inxhinierisë së mjedisit”;

Për punimet speciale të ndërtimit:

- NS-1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”;
- NS-2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”;
- NS-4 A “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese”;
- NS-8 A “Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri”;
- NS-12 A “Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit”;
- NS-14 A “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV”;
- NS-18 A “Punime topogjeodezike”;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategorite dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 2,3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

KAT.	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Nr. An	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli I klasifikimit I kerkuar per kategorine respektive
NP-1	Punime gërmimi në tokë	2.26	Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m ³ ,shkarkimi ne auto	Niveli A
		2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	Perfshihet ndertimi i ambjenteve te kopshtit		Niveli A
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Rikonstruksioni i plote i godines ekzistuese ku perfshihet shtrimi me pllaka dhe parket, suvatim i brendshem dhe i jashtem, termoizolimi i godines, veshje fasade, dyert dhe dritaret e reja, sistemi elektrik nga e para, sistemi ngrohjes nga e para etj.		Niveli A
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit	3.643/a	F.V. Dhe' vegjetal per mbushje (brezat e gjelber)	Niveli A
		3.643	Mbjellje bari ne skarpat	
NS-1		2.426/1	Prishje mur tulle me pastrim	Niveli A
		2.426/2	Prishje çatie ekzistuese me tjegulla	

	Punime për prishjen e ndërtimeve	2.426/11	Prishje suvatim muri i brendshëm	
		2.426/3	Prishje shtresa betoni	
		2.197/1	Prishje e hidroizolimit ekzistues (tarrace)	
		2.405/1	Heqje davancialet dritarësh	
		2.208/1	Cmontim - heqje ulluqesh horizontale e vertikale	
		2.281	Heqje pllaka dysHEMEJE	
NS-2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	Niveli A
		2.494/1	F.V. Saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm	
		2.495	F.V. Lavaman porcelani	
		2.499	F.V. Lavapjate llamarine	
		2.501	F.V. ËC allafrenga	
		2.515	F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 50	
		2.491/c	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16	
		2.491/2d	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, t = 3.0 mm, Pn 10	
		2.488	F.V. Rezervuari zingato 5000 litra	
		2.512/2	F.V. Kolektor shpendares 3/4" (4+4)	
		2.614	Hapje vrimash ne mur deri ne Ø 200 mm	
		2.512/3	F.V. Kolektor shpendares 3/4" (5+5)	
		2.491/d	F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16	
		2.508	F.V. Bolier 100 l	
		2.336	Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm	
		2.234	Pusete shkarkimi 50 x 50, h = 100 cm	

		An.F01	Furnizim dhe vendosje tubash dhe rakorderish çeliku te galvanizuar DN 1 1/2"	
		An.F02	Furnizim dhe vendosje hidrant mural DN 1" (DN25) L=20ml (Naspo)	
		An.F03	Furnizim dhe vendosje tubash dhe rakorderish çeliku te galvanizuar DN 1"	
		An.F04	Montim pompe zjarri (set elektrike, nafte, starter) perfshi aksesoret	
		An.H01	Furnizim dhe vendosje tubash dhe rakorderish polietileni te nderlidhur PEX d=12mm PN20 - Uje i ftohte	
		An.H02	Furnizim dhe vendosje tubash dhe rakorderish polietileni te nderlidhur PEX d=12mm PN20 - Uje i ngrohte	
		An.H03	Furnizim dhe vendosje tubash dhe rakorderish polietileni te nderlidhur PEX d=25mm PN20 - Uje i ftohte	
		An.H04	Furnizim dhe vendosje tubash dhe rakorderish polietileni te nderlidhur PEX d=32mm PN20 - Uje i ftohte	
		An.H05	Montim pompe furnizimi me uje, booster set 1+1 me ene zgjerimi dhe testim i pompes	
		An.H06	Furnizim dhe vendosje grup ujmatesi 1 1/2" perfshi te gjithë rakorderite prej bronzi si ne detaje	
		An.H07	Furnizim dhe vendosje profil metalik ankorues ne mur per ËC allafrenga me inkaso	
		An.H08	Furnizim dhe vendosje profil metalik ankorues ne mur per lavamane murale	
		An.H09	Furnizim dhe vendosje tubash dhe rakorderish shkarkimi PP-HTEM me d=50mm	
		An.H10	Furnizim dhe vendosje tubash dhe rakorderish shkarkimi PP-HTEM me d=75mm	
		An.H11	Furnizim dhe vendosje tubash dhe rakorderish shkarkimi PP-HTEM me d=110mm	
		An.H12	Furnizim dhe vendosje sifoni PP-HTEM d=75~110mm	

		An.H13	Furnizim dhe vendosje pike kontrolli PP-HTEM d=110mm	
		An.H14	Furnizim dhe vendosje tuba dhe rakorderi HDPE te brinjezuara d=160mm per linja te jashtme kanalizimesh	
		An.H15	Furnizim dhe vendosje tuba dhe rakorderi HDPE te brinjezuara d=250mm per linja te jashtme kanalizimesh	
		An.H16	Furnizim dhe vendosje tuba dhe rakorderi PVC-U d=110mm per linja te jashtme drenazhimi	
		An.H17	F.V. Pilete grumbulluese PVC-U, e adaptueshme me kllapa per ullqe xingato	
		An.H18	F.V. Pusete plastike tip kurth ne dalje te kollona te shkarkimit	
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	2.388/1	F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara	Niveli A
		2.375/1	F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham	
		2.373/1	F.V. Vetrare d/alumini plastike me dopio xham	
		2.395/1	F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham	
		2.373/a	Vetrato xhami i temperuar	
		2.273/5	Shtrese me pllaka mermeri t=3cm	
		2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanat	
		2.578	Shtrese me pllaka terrakote	
		2.267b	Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm	
		2.273/1	Shtrese me pllaka graniti t=2cm	
		2.273/4	Shtrese me pllaka mermeri t=2cm	
		2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	
		2.200	Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm	

		2.219	Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze	
		2.196/c	Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B	
		2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	
		2.203	Veshje kornize llamarine xingat	
		2.358/b	Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.	
		2.310/1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25	
		2.324b	Plintuse grez h = 10 cm	
		2.328	Patinim muri allçi (stuko)	
		2.306	Suvatim shpatullash ne rikonstruksion	
		2.300/1	Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe	
		2.330	Patinim tavani allçi (stuko)	
		2.70/2	Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25	
		2.108/1c	Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa kunder lageshtires	
		2.64/2	Mur me tulla te plotu zak, deri 3m, llaç perzier M 25	
		2.276/a	Shtrese parketi laminat	
		2.423/a	Shtrese avullizoluese gjeotekstil	
		2.401	Boje vaji siperfaqe metalik	
		2.404	Boje hidroplastike	
		2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	
NS-8	Ndërtim parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	2.117/1b	Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m	Niveli A
		2.574	Trare e arkitrare b/a C 25/30	
		2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	

		2.166/1a	F.V. Hekur betoni periodik $\varnothing > 12 \text{ mm}$	
		4.1	F.V Konstruksione metalike te perbera	
		4.3	Konstruksione metalike te thjeshta	
NS-12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit	An.M01	F.V Tub bakri per gaz ftohes R410A $\varnothing 6.35$, $\delta= 0.8 \text{ mm}$ konform EN 12735-1, I termoizoluar nga fabrika me trashesi izolimi 13mm, i kompletuar me gjithë rakorderi.	Niveli A
		An.M02	F.V Tub bakri per gaz ftohes R410A $\varnothing 9.52$, $\delta= 0.8 \text{ mm}$ konform EN 12735-1, I termoizoluar nga fabrika me trashesi izolimi 13mm, i kompletuar me gjithë rakorderi.	
		An.M03	F.V Tub bakri per gaz ftohes R410A $\varnothing 12.7$, $\delta= 0.8 \text{ mm}$ konform EN 12735-1, I termoizoluar nga fabrika me trashesi izolimi 13mm, i kompletuar me gjithë rakorderi.	
		An.M04	F.V Tub bakri per gaz ftohes R410A $\varnothing 15.88$, $\delta= 1.0 \text{ mm}$ konform EN 12735-1, I termoizoluar nga fabrika me trashesi izolimi 13mm, i kompletuar me gjithë rakorderi.	
		An.M05	F.V Tub bakri per gaz ftohes R410A $\varnothing 19.05$, $\delta= 1.2 \text{ mm}$ konform EN 12735-1, I termoizoluar nga fabrika me trashesi izolimi 13mm, i kompletuar me gjithë rakorderi.	
		An.M06	F.V Tub bakri i per gaz ftohes R410A $\varnothing 22.22$, $\delta= 1.2 \text{ mm}$ konform EN 12735-1, I termoizoluar nga fabrika me trashesi izolimi 13mm, i kompletuar me gjithë rakorderi.	
		An.M07	F.V Tub bakri shufer per gaz ftohes R410A $\varnothing 28.58$, $\delta= 1.2 \text{ mm}$ konform EN 12735-1, I I kompletuar me gjithë termoizolim me trashesi jo me pak se 13mm, dhe me rakorderite e nevojshme per montim.	
		An.M08	F.V Tub bakri shufer per gaz ftohes R410A $\varnothing 31.8$, $\delta= 1.2 \text{ mm}$ konform EN 12735-1, I I kompletuar me gjithë termoizolim me trashesi jo me pak se 13mm, dhe me rakorderite e nevojshme per montim.	
		An.M09	F.V Aksesor dhe rakorderi per instalimin e tubacioneve te bakrit per sistemin VRF	

		An.M10	F.V Komplete degezuesish "Y" per sistem me 2 tuba, deri ne 33.5 kË, I kompletuar me gjithë aksesore per montim.	
		An.M11	F.V Komplete degezuesish "Y" per sistem me 2 tuba, deri ne 33.5÷50.6 kË, I kompletuar me gjithë aksesore per montim.	
		An.M13	F.V Kabull komunikimi I skermuar 3x1.5 mm, per lidhjen ne seri te pajisjeve te brendeshme me grupet e pajisjeve te jashtme. Kompletuar me gjithë rakorderi.	
		An.M14	F.V Gaz ftohes R410A per mbushjen e sistemit VRF, kompletuar me gjith vakum te sistemit dhe mbushje.	
		An.M15	F.V Tub Kondensash PP me gota D 50 kompletuar me gjithë rakorderite dhe aksesoret e nevojshem per montim.	
		An.M16	F.V Tub Kondensash PP me gota D 40 kompletuar me gjithë rakorderite dhe aksesoret e nevojshem per montim.	
		An.M17	F.V Tub Kondensash PP me gota D 32 kompletuar me gjithë rakorderite dhe aksesoret e nevojshem per montim.	
		An.V01	F.V Kanale ajri prej Panel poliuretani me trashesi 21 mm i veshur me flete alumini 80 micron, së bashku me aksesoret e prodhimit të kanaleve, perforcimin, izolimin me silikon, dhe fllanxhat me alumun te anodizuar, perfshire sistemin e instalimit dhe fiksimit.	
		An.V02	F.V Grila 30x15 me 2 rreshta të lëvizshëm kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshem per montim.	
		An.V03	F.V Grila 20x10 me 2 rreshta të lëvizshëm kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshem per montim.	
		An.V04	F.V Grila shiu me fleta fikse 50x30 kompletuar me gjithë aksesoret e nevojshem per montim.	
	Impiante të brëndëshme, elektrike, telefoni,	2.480/2	F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm	Niveli A
		2.480/3	F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm	

radiotelefoni TV etj	2.480/5	F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm
	2.485/d	F.V. Priza shuko universal
	2.487/b	F.V. Kuti suport pllaket 4 mod
	2.485/1	F.V. Çeles 1 polar 220V 10A
	2.457	F.V. Ndricues fluoreshent 1x18ë.IP65
	2.473	F.V. Ndricues evakuimi me llampe 1x11ë,IP40
	2.496	F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m
	3.176	F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086
	3.590	F.V. Pusete betoni me kapak gize dhe gjithë aksesoret + tokezuesit 40x40x40
	An.E01	F.V Kuti plastike 3 module, brenda murit me kapak IP 55
	An.E02	F.V Kuti plastike 4 module, brenda murit me kapak IP 55
	An.E03	F.V Suporte, kapak, 3 module
	An.E04	F.V Tapa Fallco
	An.E05	F.V Prize Industriale CEE 16A, 400V, (L1, L2, L3, N, PE), IP 44
	An.E08	F.V Kuti shperndares , montim brenda murit PT-6, IP40
	An.E09	F.V Kuti shperndares, montim brenda murit PT-7, IP 40
	An.E10	F.V Tub i drejte rigid Ø=25mm, se bashku me brryla, Ti, bashkuese, aksesore per fiksimin e tubit ne tavan etj
	An.E11	F.V Tub i drejte rigid Ø=20mm, se bashku me brryla, Ti, bashkuese, aksesore per fiksimin e tubit ne tavan etj
	An.E12	F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16R16 type, S = (3x50+1x25)+1x25mm²

		An.E13	F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 5 x 10 mm ²	
		An.E14	F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 5 x 6 mm ²	
		An.E15	F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 5 x 4 mm ²	
		An.E16	F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 4 mm ²	
		An.E17	F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 2,5 mm ²	
		An.E18	F.V Terminale fundore per kabllo TU Un=0.6/1 kV; S=50mm ²	
		An.E19	F.V Terminale fundore per kabllo TU Un=0.6/1 kV; S=(6-16)mm ²	
		An.E20	F.V Terminale fundore per kabllo TU Un=0.6/1 kV; S=(1.5-4)mm ²	
		An.E21	F.V Paneli Elektrik Kryesor [P.E.K], Sipas skemes ne projekt	
		An.E24	F.V Kuadri Elektrik Shperndares [K.E_K0], Sipas skemes ne Projekt	
		An.E25	F.V Kuadri Elektrik Shperndares [K.E_K+1], Sipas skemes ne Projekt	
		An.E26	F.V Çeles buton pulsant 16A, 230V	
		An.E27	F.V Kuti shperndares 10x10x10cm, montim jashte tavanit IP55	
		An.E28	F.V Kabllo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 1,5 mm ²	
		An.E29	F.V Kabllo multipolar bakri, Un=0,6/1 kV, tip FTG10OM1 type, S = 3 x 1,5 mm ² , rezistent ndaj zjarrit perj 90min	

	An.E30	F.V Percjelles nje polar, me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=450/750 V, tip N07V-K, S = 1 x 1.5 mm ²	
	An.E31	F.V Kablo i kuq alarmi zjarri, rezistent ndaj zjarrit S=2x1mm ² , tipi FG40HM1, PH.30min	
	An.E33	F.V Priza interneti, tip RJ-45 FTP - Cat.6, metalike e skermuar	
	An.E34	F.V Konektore lidhes rrjeti me dy koka RJ-45 FTP-Cat.6, L=0.5m, metalike e skermuar	
	An.E35	F.V Kablo rrejt kompjuterik , tip F/FTP - Cat.6, 350MHz deri ne 400 MHz, LSZH	
	An.E36	F.V Koka per kablo rrjeti, tip RJ-45 FTP-Cat.6, metalike e skermuar	
	An.E37	F.V Aksesore montimi te pershtatshem per instalimin e kamerave te jashtme dhe te brendshme	
	An.E38	F.V Shirit zingato Fe/Zn 30x5mm	
	An.E39	F.V Shtize rrufeprite, tub zingato Ø=20mm, H=50cm, per mbrojtjen nga goditjet atmosferike	
	An.E40	F.V Percjelles bakri I veshur me izolim PVC, ngjyre verdhe-jeshile CU, S=1x35 mm ²	
	An.E41	F.V Shkeputes tokezimi, per matjen e rezistences	
	An.E42	F.V Zbare tokëzimi bakri me 8 terminale, 23 x 5 x 5mm	
	An.E43	F.V Morseta bashkuese "T" & "X" universale tokezimi 30x5mm	
	An.E44	F.V Aksesore fiksues per instalimin e shiritave zbrites ne mur me sistem kapote, I kompletuar me upe, prizhonier dhe distancator	
	An.E45	F.V Kubike betoni me izolim PVC 10x10x15cm	
	An.E46	V UPS, 1-fazor, montim ne rack	
	An.E47	V Ndriçues LED Panel, i montuar jashte tavanit, 60x60cm, 36Ë, 3600lm, 4000K	

	An.E48	V Ndriçues cilindrik LED, i montuar jashtë tavanit 25Ë, 2300lm, 4000K	
	An.E49	V Ndriçues plafon rrethor LED jashte murit, 18Ë, IP44	
	An.E50	V Ndriçues industrial LED L=1.2m, 43Ë, IP 65, 4000K, me difuzor opal hermetik	
	An.E51	V Central i alarmit te zjarrit, me 1 loop, tip inteligjent, i adresueshem, me regjistrim ngjarjesh, modul komunikimi, grafik karte, me porte kompjuterike, i programueshem, i pajisur me bateri me 72 ore pavaresi (Programim, testim & komisionim i sistemit te detektimit te zjarrit)	
	An.E52	V Detektore tymi multi sensitiv, inteligjent te adresueshem, me modul komunikimi	
	An.E53	V Detektore temperature multi sensitiv, inteligjent te adresueshem, me modul komunikimi	
	An.E54	V Pulsant manual alarmi zjarri (me thyerje xhami), inteligjent i adresueshem me modul komunikimi, tip 1469, IP-55	
	An.E55	V Sirena alarmi zjarri, me ndricues me llambe vezulluese, per vendosje ne ambient te brendshem, tip inteligjent te adresuesheme, me intesitet 120dB.	
	An.E56	V RACK kompjuetrik 19" 15U (Dimesionet 600x600x760mm), me 2 module ushqimi me 8 priza " Shuko " 230V/16A + PE, I kompletuar grupin e modulit te ventilimt	
	An.E57	V Patch panel per rrjetin e internetit + TF, me 24 porta RJ-45, tip FTP-Cat.6	
	An.E58	V Sëitch per rrjetin e IT-së, me 16 porta RJ-45 + 2 porte per fiber optike, tip FT -Cat.6	
	An.E59	V Patch cord fiber optike me 2 koka konektorale L=1m	
	An.E60	V Kamera e brendshme, tip Dome POE IP, 5Mpx	
	An.E61	V Kamera e jashtme, tip Bullet IP POE, 5Mpx, IP 66	

		An.E62	V NVR (Netëork Video Recorder), me 16 kanale, 1U, 19" per montim ne rack, (Programim, testim & komisionim i sistemit te vezhgimit CCTV)	
		An.E63	V Patch panel per rrjetin e CCTV, me 16 porta RJ-45, tip FTP-Cat.6	
		An.E64	V Sëitch i menaxhueshem Smart POE me 16 Porta RJ45 FTP Cat.6 + 2 porte per fiber optike, tip FT -Cat.6	
		An.E65	V HDD 4TB 3,5 inch. Kapaciteti 4000GB, Sata. Purple HDD (i dizenuar vecanerisht per Security, per te punuar 7dite ne Jave, 24 ore. Si edhe me jetegjatesi me te gjate se nje HDD i zakonshem kompjuteri ndaj ofron me shume garanci ne sherbim)	
		An.E66	V Monitor 32" LED, per monitorimin e kamerave	
		An.E67	F.V Shirit zingato Fe/Zn d=10mm	
		An.E68	F.V. Tub korrogato Ø63 mm me dy shtresa	
NS-18	Punime topogjeodezike	2.258	Nenshtrese zhavori	Niveli A
		2.261	Shtrese rere	
		2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	
		2.288	Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit	

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist 1 (nje)
- Inxhinier Gjeoteknik 1 (nje)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet 1 (nje)
- Arkitekt 1 (nje)
- Inxhinier Elektrik 1 (nje)
- Inxhinier Elektronik/Telekomunikacioni 1 (nje)
- Inxhinier Mekanik 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Materialesh 1 (nje)

Për drejtuesit teknik të paraqitet diploma, kontrata noteriale e punës, si dhe te figurojne ne

listepagesat e shoqerise në datën e hapjes se tenderit .

* Në lidhje me Inxhinierin Elektronik/Telekomunikacioni, duhet të jetë i çertifikuar në nivel profesional për netëork nga organizma të mirënjohura ndërkombëtare si CCNP Cisco, ose CompTIA Netëork+, ose PCNSE, ose Fortinet NSE7 ose ekuivalente.

* Njëri nga drejtuesit teknik duhet të jetë i pajisur me "Çertifikatë për Auditues Energjistik në Ndërtesa", lëshuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për çertifikimin si më sipër kerkohet, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikates, si dhe institucionin/organizatën që ka lëshuar këtë çertifikim.

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese".*

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për Inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i Inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Inxhinieri i Ndërtimit (profili Strukturist) kerkohet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të cilat përfshijnë ndërhyrje në muraturë mbajtëse (hapje dhe konstruksione ndihmëse sipas projektit) si dhe konstruksione metalike mbajtëse.

Inxhinieri Gjeoteknik është i nevojshëm pasi ai do të verifikojë në terren kapacitetet mbajtëse të tokës dhe qendrueshmërinë e themeleve të objektit ekzistues gjatë ndërhyrjeve të propozuara të përforcimit të themelit, parashikuar në projektin strukturor. Këto ndërhyrje janë parashikuar të realizohen në perimetrin e plotë të objektit, e gjatë ndërhyrjeve i gjithë themeli i objektit do të jetë i ekspozuar.

Verifikimi i kushteve mekanike dhe fizike të tabanit dhe llogaritja e uljeve diferenciale të tabanit gjatë ndërhyrjeve janë të rëndësishme për të siguruar që ndërhyrjet e realizuara për përdorimin e themelit jo vetëm të rrisin kapacitetin mbajtës por edhe të realizohen me përpikmëri e pa probleme.

Inxhinier Topograf/Gjeodet është i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike duke përfshirë punime si piketimi, rievime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhurnime të ndryshme, persa i përket sistemimit të terreneve të jashtme.

Arkitekti është vendosur si kriter pasi është e nevojshme për të udhëhequr dhe realizuar me cilësi punimet e rifiniturës, suvatim të jashtëm, elementet dekorativë, veshjet me pllaka në fasadë, cilësinë e lysterjeve, ngjyrat, fasadat etj.

Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, sipas parashikimeve në projektet Elektrike përkatëse. Zërat e përfshirë në preventiv shoqërohen me zgjidhet teknike të hartuara nga eksperti inxhinier elektrik në projekt, në relacionin teknik dhe specifikimet teknike. Për këtë arsye, lind nevoja që për zbatimin e punimeve në të gjitha vëllimet e objektit të angazhohet një inxhinier elektrik të përfshirë në licensën e shoqërisë.

Inxhinieri Elektronik/Telekomunikacioni është i nevojshëm për procesin e instalimit të sistemit të survejimit me kamera CCTV, sistemit të access control-s për kontrollin e hyrje-daljeve, rrjetin LAN, sistemin e detektimit të zjarrit, instalimin e pajisjeve si Rack, UPS, etj.

Lidhur me kërkesën për inxhinierin elektronik/telekomunikacioni që të jetë i certifikuar në nivel profesional për netëorë nga organizma të mirënjohura ndërkombëtare si CCNP Cisco, ose CompTIA Netëorë+, ose PCNSE, ose Fortinet NSE7 ose ekuivalente, mbahet në konsideratë se kjo certifikatë është shumë e nevojshme kur ka punime në rrjetin e internetit, rrjetin IT, punimet e telefonisë, sistemet e kamerave dhe të sigurisë etj. dhe kërket drejtim, lidhja dhe konfigurimi i ketyre rrjeteve dhe pajisjeve. Gjithashtu parashikohet instalim i sistemit komunikimi të dhenave për të sinkronizuar edhe me sistemet e sinjalizimit kundër zjarrit. Me konkretisht nepermjet këtij kualifikimi vërtetohen njohuritë dhe aftësitë që nevojiten për të instaluar, konfiguruar, operuar dhe zgjidhur një rrjet ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme, sic kërket dhe në preventivin e punimeve.

Inxhinieri Mekanik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, ku përfshihet komplet sistemi i ngrohjes dhe sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit MNZ sipas parashikimeve në projektin mekanik dhe MNZ.

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike duke përfshirë furnizimin dhe vendosjen e tubave dhe rakorderive, pajisjeve hidrosanitare (ËC,

lavaman,, rubineteri etj), furnizimin e ujit sanitar, sistemin MNZ, dhe sistemin e kanalizimeve dhe shkarkimeve, lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.

Inxhinieri i Materialesh është përgjegjës për zbatimin e zërave të preventivit ku kemi të bëjmë me punimet si beton, asfalt ose materialet e dritareve, suvase etj Inxhinieri luan rol qe materialet te jene sipas specifikimeve teknike ose ne porcion per te siguruar kushtet normale si psh ne rastin e betonit marken e kerkuar . Duke qene nje objekt arsimor si kopeshti cilesia e materialeve luan nje rol kyc ndaj lind nevoja e ketij inxhinieri .

Meqe ky eshte nje proces qe do te paguhet nga ana e Autoritetit Kontraktor, njesia e prokurimit arsyeton se operatori ekonomik fitues duhet ta plotesoje kete kriter.

2.3.4 KrahastafiteteknikOperatoretEkonomike duhet te kene te punesuar staf e punonjesve te kualifikuar ne perputhje me ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqiperise.” si me poshte:

- Teknik Ndertimi	1 (nje)	Diplome shkolle e mesme
- Teknik Mekanik	1 (nje)	Diplome shkolle e mesme
- Teknik Gjeometer/Topograf	1 (nje)	Diplome shkolle e mesme
- Elektricitist	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Hidraulik	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Hidroizolues	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Specialist ngrohje-ftohje	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Karpentier	1(nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Hekurkthyes	1(nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Betonues	1(nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Murator	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Suvatues	5 (pese)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Punetor veshje fasade	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Pllakashtues	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Montues parketi	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Bojaxhi	5 (pese)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Punetor duralumini	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Punonjes Gipsi	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Saldator	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Pergatites te konstruksioneve metalike	3 (tre)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Marangoz/Mobilier	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale/Diplome
- Shofer	3 (tre)	Leje Drejtimi kategoria C minimalisht
- Manovrator	3 (tre)	Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome/Deftese te Shkolles se Mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme, Dëshmi te Sigurimit Teknik e leshuar nga ISHTI ose nga nje trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si dhe te të figurojnë në listpagesat e shoqërisë në datën e hapjes së tenderit .

(Në rastin kur makineritë disponohen me qera për shoferët dhe manovratorët nuk kërkohet disponimi i tyre në listpagesat e shoqërisë, pasi këto punonjës mund të kontraktohen).

Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

*Njeri prej elektricisteve te kerkuar si me siper, duhet te jete i kualifikuar/certifikuar per instalimin e paneleve diellore, nga institucione publike/private te licensuara sipas legjislacionit ne Republiken e Shqiperise.

*Lidhur me saldatoret e kerkuar si me siper, duhet te jene te kualifikuar/ certifikuar sipas standardit SSH EN ISO 9606-1, sa i perket kerkesave per testimin dhe kualifikimin e saldatoreve per saldimin e celiqeve, nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërise.

*Njeri prej hidraulikeve te kerkuar si me siper, duhet te jete i kualifikuar/certifikuar sipas standardit SSH EN 13067, sa i perket kerkesave per saldimin e tubove me termoplastike, nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërise.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për kualifikimet/certifikimet si më sipër kerkohet, emër/mbiemër, numrin dhe datën e certifikates, si dhe institucionin/organizatën që ka lëshuar kualifikimet/certifikatat perkatese.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor

të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantojë që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”*. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional.

Teknik Ndërtimi janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve. Kërkesa e AK për Teknike Ndërtimi vjen pasi objekti ka punime të ndryshme ndërtimore dhe duhet bërë ndjekja e tyre në terren. Për këtë arsye gjykohej e arsyeshme prania e punonjësve të tillë në mënyrë që të arrijnë të kontrollohen punimet specifike në çdo fazë.

Tekniku Mekanik është i nevojshëm për ndjekjen e zbatimit të projektit mekanik, për realizimin e sistemit të ngrohjes, sistemin MNZ dhe furnizimin me ujë të ngrohtë.

Tekniku Gjeometër/Topograf është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të ndërtimit nga e para si dhe punimet e sistemit të jashtëm. Të gjitha këto punime kërkojnë precizion në kuota dhe nivele të caktuara për piketimin dhe monitorimin e strukturave dhe elementeve të ndryshëm.

Elektrici 2(dy) janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve elektrike, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Hidraulike 3 (tre) persona janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve hidraulike, sipas zërave të preventivave të punimeve. Duke marrë në konsideratë faktin se punimet për sistemin hidraulik do të fillojnë të kryhen (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish hidraulik.

Specialiste për sisteme ngrohje-ftohje 2 (dy) janë të nevojshëm pasi punimet e sistemit të ngrohjes zënë një pjesë të konsiderueshme në zërat e preventivave të punimeve.

Karpiçier 1 (një) janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen punime betoni, kallëpet, shtresat dhe hekuri periodik ndërtimi, montimi i skelave për punimet në lartësi, etj.

Duke qenë se punimet e hekurit janë në volume të mëdha si më sipër listuar, duke u bazuar edhe se këto punime nuk mund të realizohen për gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës si për rikonstrukcionin e kopeshtit, si dhe referuar orëve të punëve për këtë kategori punimesh ku është

relativisht e madhe njësia e prokurimit gjykon se kë kërkuar një numër minimal punonjësish, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për **Hekurkthyes 1(nje)**.

Betonues 1(nje) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të betonimit, me klasen e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Murator 2 (dy) janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve të muratures.

Suvatues 8 (tete) janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve suvase së brendshme , suvatimeve të soletes dhe parapetit sipas zërave të preventivave të punimeve.

Punetor Veshje Fasade 3 (tre) janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve të fasades,

Pllakashtrues 3 (tre) janë të nevojshëm për shtrimet e dyshemeve me pllaka mermeri, porcelani, si dhe veshjen e tualeteve me pllaka etj, për kopeshtin ekzistues.

Montues Parketi 3 (tre) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të shtresave, me materialin e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Bojaxhinj 5 (pese) janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të lyerjeve të brendshme dhe fasadës, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Punonjes duralumini 2 (dy) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të dyer/dritare, me materialin e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Punetor gipsi 2 (dy) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të shtresave, me materialin e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Saldator 3 (tre) dhe pergatites konstruksione metalike 3 (tre) janë të nevojshëm pasi në zerrat e preventivit përfshihen për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Hidroizolues 2 (dy) janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të hidroizolimit, me materialin e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Marangoz / Mobilier 2 (dy) janë të nevojshëm për realizimin e vendosjes së dyerve të brendshme sipas zërave të preventivave të punimeve.

Manovrator 3 (tre), Shofera 3 (tre)

Lidhur me kriterin e sipërcituar, njësia e prokurimit sqaron se punonjësit e mësipërm kërkohen në funksion të manovrimit të mjeteve të listuara si më poshtë;

Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 10 ton (cope 2), Kamionçina me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton (cope 2), Autobetoniere (1cope), Autopompe betoni (1 cope).

Eskavator me goma (cope 1), Fadrome me goma (cope 1), Minieskavator (cope 1), Minifadrome/Bobcat (cope 1), Rul ngjeshes (1 cope).

2.3.5 Operatores ekonomik pjesemarres duhet te kene te punesuar si staf mbeshtetes per kryerjen e proceseve ne kete objekt, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, te pajisur me çertifikate/deshmi kualifikimi te leshuar nga subjekte te licencuar/akredituar sipas ligjit, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise minimalisht per datën e hapjes se tenderit , punonjes me specialitetin si me poshte:

- 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë si Ekspert Zjarrfikës, per dhenien asistences teknike ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, ne mbeshtetje te pikes 4 te nenit 49 te ligjit nr. 152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin”.

**Per permbushjen e ketij kriteri, operatori ekonomik ofertues, ne formularin permbledhes te vetdeklarimit, Deklarata B, duhet te deklarroje emer/mbiemer, titullin e kualifikimi/certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, daten e leshimit te saj dhe emrin e organit kualifikues/certifikues kompetent.*

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr.152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin“, ku citohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep çertifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

- 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e

rregullores”, “Për sigurinë në kantier”, lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Per permbushjen e ketij kriteri, operatori ekonomik ofertues, ne formularin permbledhes te vetdeklarimit, Deklarata B, duhet te deklaroje emer/mbiemer, titullin e kualifikimi/certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, daten e lesimit te saj dhe emrin e organit kualifikues/certifikues kompetent.*

2.3.6 Operoret ekonomik pjesemarres duhet te kene te punesuar si staf mbeshtetes per kryerjen e proceseve ne kete object, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, te pajisur me çertifikate/deshmi kualifikimi te lëshuar nga subjekte te licencuar/akredituar sipas ligjit, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise minimalisht per datën e hapjes se tenderit , punonjes me specialitetin si me poshte:

3 (tre) punetor veshje fasade dhe 3 (tre) pergatites te konstruksioneve metalike, te trajnuar per punime ne lartesi te cilet te jene te pajisur me çertifikate “Per punimet ne lartesi”, lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Per permbushjen e ketij kriteri, operatori ekonomik ofertues, ne formularin permbledhes te vetdeklarimit, Deklarata B, duhet te deklaroje emer/mbiemer, titullin e kualifikimi/certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, daten e lesimit te saj dhe emrin e organit kualifikues/certifikues kompetent.*

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” ku citohet..... “*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion*”.

Specialisti per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune harton planin e sigurisë dhe të koordinimit ne kantier, parapërgatit një dosje, e cila përmban informacionet e nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar punëtorët, hartojnë planin operativ të sigurisë, kryejnë mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodic të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve.

Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe

me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilët janë të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" dhe "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shendetit në punë.

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e proceseve në këtë objekt, të vertetuar me kontratë pune të vlefshme, të pajisur me certifikate/deshmi kualifikimi të lëshuar nga subjekte të licencuar/akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimalisht për datën e hapjes së tenderit, punonjes me specialitetin si më poshtë:

1 (një) Inxhinier, i kualifikuar si Koordinator Saldimi sipas standartit SSH EN ISO 14731, lidhur me koordinimin dhe menaxhimin e saldimeve (Detyrat dhe Përgjegjësitë), lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues, në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, Deklarata B, duhet të deklarojë emer/mbiemer, titullin e kualifikimi/certifikimit, numrin e regjistrimit/certifikates, datën e lëshimit të saj dhe emrin e organit kualifikues/certifikues kompetent.*

Argumentimi: ISO 14731 është baza për përshkrimin dhe vlerësimin e detyrave dhe përgjegjësisë për personelin e koordinimit të saldimit. Referuar preventivit kemi të bëjmë me një volum relativisht të lartë të punimeve të saldimit pasi do të ndertohet shkalla e emergjencës, catia e palestres së re do të jetë e gjitha me konstrukcion metalik, dhe rrethimi i oborrit do të bëhet me kangjella, ku kerkohet prerja dhe saldimi i tyre në vend. Ky standard përcakton kërkesa specifike për kompetencën e personave me përgjegjësi saldimi dhe kjo përfshin: saldatorët, personelin NDT, inspektorët e saldimit dhe koordinatorët e saldimit. Në mënyrë që i gjithë procesi i saldimit të quhet i certifikuar dhe me siguri maksimale nevojitet praninë e një koordinatori saldimi.

** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për të kërkuar sqarime nga AK.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontratë duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **65** (gjashtedhjetë e pesë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimalisht për datën e hapjes së tenderit. Vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për datën e hapjes së tenderit.
- Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për datën e hapjes së tenderit

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përqipet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 65 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në katër elementet e strukture së kostos (material, puntori, makineri, transport). (Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore).

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH **ISO 45001:2018** e përditësuar, ose (SSH EN **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH EN **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Certifikatën SSH EN **ISO 3834-2:2021**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Cilesise ne Saldim e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.14 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do

të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001:2018 është standart ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

EN-ISO 3834-2:2021 është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues që merr persiper punime saldimi, duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (strukturat metalike për ndertimin e palestres, shkalla e emergjences etj. ku ka edhe saldime), me ritjen e cilësive të ndertimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me EN-ISO 3834-2:2021/ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të çojnë në carje të njeve.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë për produktet/materialet/pajisjet si më poshte:

- 1 **Profile per dritare dhe dyer d/alumini plastike:** Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate ose Raport Testimi nga laboratorë të certifikuar ne perputhje me standartet SSH EN 477 (*përcaktimi i rezistencës në goditje të profileve plastike*) dhe SSH EN 479 (*përcaktimi i kthimit të nxehtësisë*).
- 2 **Celik per konstruksione metalike:** Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të certifikuar ne perputhje me standartin SSH EN 10025-1 ose ekuivalente (*përsa i përket celikut te perdorur ne struktura metalike*)
- 3 **Fasade me polisterol+rrjete+suva (Sistemi kapote):** Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të certifikuar ne perputhje me standartin SSH EN 13499 ose ekuivalente (*ne perputhje me kerkesat per sistemet e izolimit termik të jashtëm të bazuar në polistiren të bymyer - Karakteristikat*).
- 4 **Boje hidroplastike (ekologjike):** Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të certifikuar ne perputhje me standartin SSH EN 11998 (*percaktimi i aftesise për t'u pastruar e veshjeve/shtresave të holla të lyrjes*) dhe certifikata nga laboratorë të certifikuar ku te vertetohet se produkti eshte ekologjik (EU ECO Label) ose ekuivalente.
- 5 **NVR smart dhe POE deri ne 16ch IP hyrje kamerash;**
- 6 **Sëitch i menaxhueshem Smart me 16 Porta per POE, 1 porte per RJ45 dhe 1 porte per fiber optike;**
- 7 **Kamera e brendshme, tip Dome POE IP, 5Mpx,;**
- 8 **Kamera e jashtme, tip Bullet IP POE, 5Mpx, IP66:**
- 9 **Panel kontrolli konvencional me 2 zona:** Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate/Vertetim ose Raport Testimi nga laboratorë të certifikuar ne perputhje me standartin SSH EN 54-2 ose ekuivalente (*persa i perket sistemeve të zbulimit dhe të alarmit të zjarrit - Pjesa 2: Pajisje kontrolli dhe tregimi*).
- 10 **Tuba PEX (Ø25,32 PN20), i termoizoluar:** Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar, te paraqitet Katalog/Skeda teknike perkatese, Certificate ku te vertetohet se keto tuba jane te sigurta nga ana higjeno-sanitare.

Argumentimi: Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga njesia e prokurimit pasi duke qënë se në objektin e prokurimit kemi të bëjmë edhe me materiale dhe pajisje që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testeve të kryera**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri ka patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin qatë punimeve për të cilën janë te domosdoshme.

2.3.12 Operatoret Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 10 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Autovinc	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Kamionçina me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Eskavator me goma (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Mineskavator	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Autobetoniere kantieri (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Autopompe betoni	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Minifadrome/Bobcat (MT)	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Kompaktor	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Depozite uji 5000 litra	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Rul ngjeshes	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Skeleri	Ne pronesi ose qira	m2	800
Armatura per kallepe	Ne pronesi ose qira	m2	75
Saldatriçe	Ne pronesi ose qira	Cope	3
Matrapik	Ne pronesi ose qira	Cope	3
Trapan magnetik per hapjen e vrimave ne metal	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Total station	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Betoniere kantieri	Ne pronesi ose qira	Cope	2
Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PPR	Ne pronesi ose qira	Cope	1
Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PEX	Ne pronesi ose qira	Cope	2

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: - certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; për secilin mjet.
- Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases/ bashkëpunimit.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit perbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Analizë të detajuar në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor:

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbi 10 ton (2 copë)

Kërkohen kamionat pasi kemi transport të lëndëve inerte, si dhe transporti i volumeve që dalin nga punimet e gërmimit për shtresat rrugore në sheshin e objektit, prishje struktura betoni etj

Autovinc; Nevojitet per ngritjen e profileve te renda te celikut per konstruksionin metalik te palestres.

Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton; prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceset si Transport i mbeturinave, materiale hidraulike elektrike etj. Ky mjet është i favorshem pasi mund te qarkulloje ne cdo orar .

Eskavator me goma; Kerkohet per germimin e themeleve per ndertimin e objektit, germim dhe mbushje per ndertimin e terreneve te jashtme.

Minieskavator; Kerkohen per germime te vogla te cilat do te behen ne shesh per kanalizimet dhe kullimet e ujrave.

Minifadrome/Bobcat; Kerkohen per sistemimin e inerteve e mbeturinave brenda kantierit.

Kompaktor; Kerkohet per ngjeshjen e dheut te kanaleve te vogla, lulishte etj.

Depozite uji 5000 litra; jane te nevojshme ne rastin kur ka mungese te furnizimit me uje, kur duhet bere llaci per suvatimet, kolla per shtrimin e pllakave, ujitja e rruges etj.

Rul ngjeshes; Eshte i nevojshem per ngjeshjen e tabanit te palestres, per ngjeshjen e cakellit para se te vihen pllakat e sheshit etj.

Skeleri 800m²; Jane te nevojshme per punimet e fasades

Armatura per kallepe 75m²; Jane te nevojshme per punimet e karpentierise tek palestra dhe shitesa e tualeteve te reja.

Saldatrice (3 cope); Duhet per saldimin e profileve metalike per konstruksionet, kangjellat etj.

Matrapik (3 cope); prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, konkretisht për prishjen e ndertimeve, heqjen e shtresave te betonit etj.

Trapan magnetik per hapjen e vrimave ne metal; Sherben per hapjen e vrimave ne metale ku inkastrohen me pas bullonat dhe prixhonieret.

Total station; kerkohet pasi kemi matje topografike persa i perket rilevimeve dhe sistemimeve te jashtme.

Betoniere (2 cope); prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me nevojën për gatitje llaci për shtresën e llustres së cimentos, llac suvatimi etj.

Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PPR; prezenca në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo vegël mundeson ngjitjen tubove PPR sipas zerave të preventivit.

Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PEX (2 cope); prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo vegël mundeson ngjitjen tubove PEX sipas zerave të preventivit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose

produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Bazuar në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin publik*” i ndryshuar, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” i ndryshuar, njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.